



Lufta kundër pandëshkueshmërisë

*Pjesë nga Raporti i Përgjithshëm i 14-të,
publikuar në vitin 2004*

25. Synimi kryesor i KPT-së është “parandalimi” i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës ose ndëshkimit; KPT-ja është më shumë e përqëndruar në të ardhmen sesa në të shkuarën. Megjithatë, përcaktimi i efikasitetit të një mase të marrë kur hasemi me një keqtrajtim është pjesë përbërëse e mandatit parandalues të Komitetit duke marrë parasysh pasojat që do të ketë një masë e tillë për qëndrimet në të ardhmen.

Besueshmëria e ndalimit të torturës dhe e formave të tjera të keqtrajtimit dëmtohet sa herë që zyrtarët që janë përgjegjës për shkelje të tilla nuk japin llogari për veprimet e tyre. Nëse shfaqja e një informacioni që tregon ushtrimin e një keqtrajtimi nuk vijon me një përgjigje të menjëhershme dhe efektive, atëherë personat që kujdesen për personat e keqtrajtuar të cilëve i është hequr liria do të krijojnë menjëherë besimin – dhe me arsye të forta – se ata mund të veprojnë kështu me siguri se nuk do të dënohen. Të gjitha përpjekjet për të nxitur parimet e të drejtave të njeriut nëpërmjet politikave të rrepta të rekrutimit dhe trainimit profesional do të sabotohen në këtë mënyrë. Duke dështuar në marrjen e masave të duhura, personat e përfshirë – kolegët, drejtuesit e lartë, autoritetet hetuese – do të kontribuojnë përfundimisht në shkatërrimin e vlerave që përbëjnë tamam themelet e një shoqërie demokratike.

Nga ana tjetër, kur zyrtarët që urdhërojnë, autorizojnë, justifikojnë ose ushtrojnë torturë dhe keqtrajtim, sillen përpara drejtësisë për veprimet e tyre ose neglizhencën e tyre, nënkuptohet një mesazh i qartë se një sjellje e tillë nuk do të tolerohet. Përveç faktit të vlerës së vetë mjaft kufizuese, ky mesazh do të risigurojë publikun e gjerë se askush nuk është mbi ligjin, as edhe ata që janë përgjegjës për ruajtjen e tij. Vënia në dijeni e faktit se personat përgjegjës për keqtrajtimin janë vënë përpara drejtësisë do të ketë një efekt përfitues edhe për viktimat.

26. Lufta kundër mosndëshkimit duhet të fillojë që në vendndodhje, si në institucionin e përfshirë (rajon policie, shërbimi i burgjeve, autoritetet ushtarake, etj.). Mjaft shpesh kjo çon në vullnetin e mirë për të qenë së bashku e për të ndihmuar njëri tjetrin kur bëhen akuza për keqtrajtme e deri në mbulimin e akteve joligjore të kryera nga kolegët e punës. Këtu kërkohet ndërmarrja e masave pozitive nëpërmjet trainimit dhe, për shembull për të **nxitur një kulturë** të tillë aty ku konsiderohet si joprofesionale – dhe e pasigurt nga pikëpamja e karrierës së personit të përfshirë – për të punuar dhe shoqëruar me kolegët që kanë ushtruar keqtrajtim kur konsiderohet si korrekte dhe shpërblyese nga ana profesionale fakti që një person i caktuar i përket një grupi që tërhiqet ndaj akteve të tilla.

Duhet të krijohet një atmosferë e tillë ku gjëja më e mirë për tu bërë është që të raportohet keqtrajtimi i kryer nga kolegët; duhet të bëhet e qartë se faji për keqtrajtimin shtrihet përtej

personave që e kanë kryer atë, deri tek ata që janë në dijeni ose që duhet të jenë në dijeni që një keqtrajtim do të ndodhë të cilët nuk marrin masa për të vepruar për parandalimin ose raportimin për një akt të tillë. Kjo nënkupton ekzistencën e një linje të qartë raportimi si dhe miratimin e masave mbrojtëse ndaj mosndëshkimit.

27. Në shumë Shtete të vizituara nga KPT-ja, tortura dhe akte të tilla si keqtrajtimi në kryerjen e një detyre, detyrimi me forcë për të marrë një deklaratë, abuzimi me pushtetin, etj., përbëjnë shkelje specifike penale që ndiqen penalisht si *ex officio*. KPT-ja mirëpret ekzistencën e dispozitave ligjore të këtij lloji.

Gjithsesi, KPT-ja ka konstatuar se në disa vende autoritetet gjyqësore kanë një liri të konsiderueshme për të vepruar në lidhje me fillimin e një hetimi paraprak kur marrin një informacion në lidhje me keqtrajtimin e mundshëm të personave që u është hequr liria. Sipas këndvështrimit të Komitetit, edhe në mungesë të një ankese formale, këto autoritete duhet të kenë një **detyrim ligjor për të ndërmarrë hetime** kurdo kur marrin informacion të besueshëm nga çfarëdolloj burimi se mund të ketë ndodhur keqtrajtim i personave që u është hequr liria. Në këtë kuadër, kuadri ligjor përta i përket përgjegjshmërisë do të forcohet nëse nëpunësit publikë (oficerët e policisë, drejtorët e burgjeve, etj.) kërkohen formalisht që të njoftojnë autoritetet përkatëse menjëherë kurdo kur ata marrin ndonjë informacion tregues për keqtrajtim.

28. Ekzistenca e një kuadri ligjor efikas nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të garantuar ndërmarrjen e hapave të duhura përta i përket çështjeve në të cilat hasen keqtrajtme të mundshme. I duhet kushtuar vëmendje e veçantë **sensibilizimit të autoriteteve përkatëse** për detyrimet e tyre mjaft të rëndësishme të cilat ata kanë për detyrë që t'i zbatojnë.

Kur personat që janë ndaluar nga njësitë e zbatimit të ligjit sillen përpara organeve të akuzës e atyre gjyqësore, jepet një mundësi mjaft e vlefshme për ta për të treguar nëse janë keqtrajtuar apo jo. Më tej, edhe në mungesë të një ankimi të shprehur, këto autoritete do të jenë në pozicionin që të ndërmarrin hapa në kohën e duhur nëse ka tregues të tjerë (për shembull, plagë të dukshme; paraqitja e përgjithshme e një personi apo qëndrimi i tij) të faktit që mund të ketë ndodhur një keqtrajtim.

Megjithatë, gjatë vizitave që ka kryer KPT-ja, ka takuar shpesh persona që akuzojnë se ata kanë parashtruar ankim për keqtrajtim tek prokurorët dhe/ose tek gjyqtarët, por bashkëfolësit e tyre kanë treguar pak interes për çështjen e tyre, madje edhe kur kanë treguar plagë të shkaktuara në pjesë të dukshme të trupit. Ekzistenca e rasteve të tilla është mbështetur nga konstatimet e KPT-së në disa raste. Duke marrë një shembull, Komiteti kohët e fundit ka shqyrtuar një dosje për një çështje gjyqësore ku, përveç regjistrimeve për akuza për keqtrajtim, vërejtje edhe plagë e enjtje në fytyrë, këmbë e kurriz të personit të përfshirë. Panvarësisht nga fakti se informacioni i regjistruar në dosje mund të thuhet se përbente prova *prima facie* të keqtrajtit, autoritetet përkatëse nuk ngritën hetime dhe nuk ishin në gjendje të jepnin një shpjegim të arsyeshëm për mosveprimin e tyre.

Gjithashtu nuk është e zakonit për personat që të akuzojnë se janë frikësuar për t'u ankuar rreth një keqtrajtimi për shkak të prezencës në seancën gjyqësore të prokurorit ose gjyqtarit bashkë me po ata nëpunës të zbatimit të ligjit që i kanë marrë ata në pyetje ose që i kanë dekurajuar për të ndërmarrë një hap të tillë me motivin që nuk do të ishte në interesin e tyre bërja e një ankimi të tillë.

Është thelbësore që organet e akuzës e ato gjyqësore të ndërmarrin masa të forta kur shfaqet ndonjë informacion që tregon keqtrajtim. Po kështu, ata duhet të drejtojnë procedimet e tyre në mënyrë të tillë që personat e përfshirë të kenë një mundësi të vërtetë për të bërë deklaratat rreth mënyrës sesi janë trajtuar.

29. **Kryerja e një vlerësimi të duhur mbi akuzat për keqtrajtime** shpesh nuk do të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Disa lloj keqtrajtimesh (si për shembull asfiksioni ose elektroshoku) nuk lënë shenja të dukshme ose nuk do të lënë shenja nëse kryhen me profesionalizëm e me masë. Po kështu, nuk kanë të ngjarë që të lenë shenja mjaft të identifikueshme as trajtime të tilla si lënia e personit në këmbë, të gjunjzuar ose kruspull për orë të tëra ose duke privuar personat nga të fjeturit. Madje edhe goditjet në trup mund të lenë vetëm shenja të lehta fizike, të vështira për t'u vënë re e që zhduken shpejt. Rrjedhimisht, kur akuzat për forma të tilla keqtrajtimi vihen re nga autoritetet e akuzës e ato gjyqësore, ata duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm që të mos i japin rëndësi mungesës së shenjave fizike. E njëjta gjë zbatohet *a fortiori* kur akuza për keqtrajtim është në mënyrë dominuese e një natyre fizike (poshtërim seksual, kërcënime për jetën ose integritetin fizik të personit të ndaluar dhe/ose familjen e tij, etj.). Vlerësimi i duhur mbi vërtetësinë e akuzave për keqtrajtim mund të kërkojë marrjen e provave nga të gjithë personat e përfshirë dhe organizimin në kohën e duhur të hetimeve në vendndodhje dhe/ose kontrolleve të specializuara mjekësore.

Në rastet kur kriminelë të dyshuar që sillen përpara autoriteteve të akuzës apo atyre gjyqësore bëjnë akuza për keqtrajtime ndaj tyre, këto akuza duhet të regjistrohen me shkrim e duhet të jepet menjëherë urdhri për një kontroll nga mjekësia ligjore (duke përfshirë, nëse duhet, kontrolli nga një psikiatër i mjekësisë ligjore) dhe duhen marrë masat përkatëse për të siguruar që akuzat të hetohen siç duhet. Një mënyrë e tillë duhet të ndiqet edhe nëse personi i përfshirë nuk ka dëmtime të dukshme të jashtme. Edhe në mungesë të një akuze të shprehur për një keqtrajtim duhet të kërkohet një mjek ligjor për të bërë kontrollin e duhur kurdo ku ka motive të tjera për të besuar se një person mund të ketë qenë viktimë e një keqtrajtimi.

30. Gjithashtu është e rëndësishme që të mos vihen barriera midis personave që bëjnë akuza për keqtrajtim (të cilët mund të jenë liruar pa u sjellë përpara një prokurori ose gjyqtari) dhe doktorëve që bëjnë raportet e karakterit ligjor që njihen nga autoritetet e akuzës apo ato gjyqësore. Për shembull, mundësia për të pasur një doktor nuk duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak nga një autoritet hetimor.

31. KPT-ja ka pasur mundësinë në një sërë raportesh të vizitave të bëra që të vlerësojë aktivitetet e autoriteteve që kanë pasur kompetencën për të kryer hetime zyrtare dhe për të paraqitur akuzat penale ose disiplinore në çështjet ku përfshihen pretendime për keqtrajtim. Gjatë kësaj detyre Komiteti merr në konsideratë precedentin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe standartet që janë në përmbajtje të një sërë instrumentesh ndërkombëtare. Tashmë është një parim i konsoliduar mirë fakti që **hetimet efektive** që janë në gjendje të çojnë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për kryerjen e keqtrajtit janë gjithashtu thelbësore për t'i dhënë një kuptim praktik ndalimit të torturës dhe trajtimit e ndëshkimit çnjerëzor e poshtëruës.

Pajtueshmëria me këtë parim nënkupton që autoritetet përgjegjëse për hetimet duhet të kenë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme, si njerëzore ashtu edhe materiale. Më tej, hetimet duhet të përmbushin disa kritere bazë.

32. Në mënyrë që një hetim mbi një keqtrajtim të mundshëm të jetë efikas është thelbësore që personat përgjegjës për kryerjen e tij të jenë të pavarur nga personat e përfshirë në ngjarje. Në disa juridiksione, të gjitha ankimet për keqtrajtime kundër policisë ose nëpunësve të tjerë publik duhet t'i paraqiten një prokurori, dhe ky i fundit – jo policia – është ai që vendos nëse duhet ndërmarrë hetime paraprake për ankimet e bëra apo jo; KPT-ja mirëpret një metodë të tillë pune. Megjithatë, është e pazakontë që gjatë ushtrimit të përditshëm të përgjegjësive në kuadrin operativ të një hetimi, ky hetim t'i shërbejë nëpunësve të zbatimit të ligjit. Përfshirja e prokurorit atëherë kufizohet në udhëzime për këta nëpunës mbi kryerjen e hetimeve, në njohjen e marrjes së rezultateve të hetimeve dhe marrjen e vendimit nëse duhet ngritur akuza për pretendimet mbi një keqtrajtim të mundshëm. E rëndësishme është që të sigurohet që nëpunësit në fjalë të mos i përkasin të njëjtit shërbim me ata

që janë subjekti i hetimit. Do të ishte e preferueshme që personat të cilëve u është besuar kryerja e punës operative të hetimit, të jenë tërësisht të pavarur nga organi i përfshirë në hetim. Gjithashtu, autoritetet e akuzës duhet të kryejnë një hetim të ngushtë e efektiv mbi kryerjen e detyrës operative të hetimit për një keqtrajtim të mundshëm nga nëpunësit publikë. Ata duhet të marrin udhëzime të qarta mbi mënyrën sesi pritet që ata të kryejnë hetime të tilla.

33. Një hetim për një keqtrajtim të mundshëm nga nëpunësit publikë duhet të jetë në përputhje me kriterin e tërësisë. Hetimi duhet të jetë në gjendje që të çojë në përcaktimin nëse është përdorur forcë apo metoda të tjera të pajustificueshme sipas rrethanave dhe në identifikimin dhe, nëse duhet, ndëshkimin e personave në fjalë. Ky nuk është detyrim për të marrë një rezultat por për mjetet e përdorura për nxjerrjen e rezultatit. Ai kërkon që të merren të gjitha hapat e duhura për të siguruar prova në lidhje me incidentin, duke përfshirë ndërmjet të tjerash, identifikimin dhe marrjen në pyetje të viktimave të pretenduara, të dyshuarve dhe dëshmitarëve (për shembull, policët në detyrë, të ndaluar të tjerë) për të gjetur instrumentet që mund të jenë përdorur në keqtrajtim dhe për të mbledhur prova për mjekësinë ligjore. Aty ku është e zbatueshme, duhet bërë një autopsi që të japë të dhëna të plota e të sakta të plagëve dhe një analizë objektive e konstatimeve klinike ku përfshihet edhe shkaku i vdekjes.

Hetimi gjithashtu duhet të kryhet në një mënyrë të kuptueshme. KPT-ja është ndeshur me çështje në të cilat, panvarësisht nga shumë incidente të pretenduara dhe fakte në lidhje me keqtrajtime të mundshme, qëllimi i hetimeve ishte kufizuar pa arsye dhe nuk ishin marrë parasysh episode të rëndësishme dhe rrethana që tregonin se ishin ushtruar keqtrajtime.

34. Në këtë kontekst, KPT-ja dëshiron që të bëjë të qartë se ka dyshime të forta në lidhje me praktikën e kryer nga nëpunësit e zbatimit të ligjit ose oficerët e burgjeve që është vërejtur në shumë vende, të cilët vënë maska ose kapuçë kur bëjnë arrestime, gjatë marrjeve në pyetje ose kur merren me shqetësimet që lindin në burgje; kjo gjë mjaft qartë do të pengojë identifikimin e të dyshuarve të mundshëm nëse dhe kur lindin pretendime për keqtrajtim. Kjo praktikë duhet të kontrollohet rreptësisht dhe të përdoret vetëm në çështje të jashtëzakonshme ku të justifikohen bindshëm; në kushtet e burgimit rrallë, nëse ndodh, do të jetë e justifikueshme.

Po kështu, praktika e konstatuar në disa vende si lidhja e syve e personave të ndaluar duhet të ndalohet patjetër pasi mund të pengojë rëndë fillimin e ndjekjes penale kundër atyre që torturojnë ose keqtrajtojnë, pasi kështu ka ndodhur në shumë raste të njohura nga KPT-ja.

35. Në mënyrë që hetimi të jete efektiv, ai duhet të kryhet në një mënyrë të menjëhershme dhe të shpenzueshme në mënyrë të arsyeshme. KPT-ja ka konstatuar raste kur aktivitete të nevojshme hetimi janë vonuar në mënyrë të pajustificueshme ose kur autoriteteve të akuzës apo atyre gjyqësore u mungonte vullneti i duhur për të vënë në përdorim mjetet ligjore që janë në dispozicionin e tyre për të reaguar ndaj akuzave ose ndonjë informacioni tjetër tregues për keqtrajtim. Hetimet në fjalë u ndërprejnë me afat të papërcaktuar ose u ndërprejnë dhe nëpunësit e zbatimit të ligjit të përfshirë në keqtrajtim ia dolën që t'i shmangeshin përgjegjësive penale që të gjithë. Me fjalë të tjera, përgjigjia ndaj provave të kërkuara për faj të rëndë kishte rezultuar në ndërmarrjen e një "hetimi" të pavlerë për emrin që mbart.

36. Në lidhje me kriterin e sipërpërmendur gjithashtu për një hetim efektiv, duhet të ketë një element të nevojshëm përse i përket mbikqyrjes publike mbi hetimin ose rezultatet e tij për të siguruar përgjegjshmërinë në praktikë si dhe në teori. Shkalla e mbikqyrjes së kërkuar shumë mirë mund të ndryshojë nga një çështje në tjetrën. Në çështje veçanërisht të rënda, mbikqyrja publike duhet të bëhet në mënyrën e duhur. Në të gjitha rastet, viktimat (ose, në varësi të çështjes, i afërmi i viktimës) mund të përfshihet në procedurën që në masën e duhur duhet të mbrojnë interesat e tij ose të saj legjitime.

37. **Procedimet disiplinore** japin një lloj tjetër forme zhdëmtimi kundrejt keqtrajtimit dhe mund të ndodhë në paralel me procedimet penale. Fajësia disiplinore e nëpunësve të përfshirë duhet të shqyrtohet në mënyrë sistematike panvarësisht nga fakti nëse faji në fjalë konstatohet se përbën një veprë penale. KPT-ja ka rekomanduar një sërë garancish procedurale që duhen ndjekur në këtë kuadër; për shembull, panelet e gjykimit për procedimet disiplinore të policisë duhet të përfshijnë të paktën një anëtar të pavarur.

38. Hetimet mbi vepra të mundshme disiplinore nga nëpunësit publik mund të kryhen nga një departament i veçantë i brendshëm hetimor brenda strukturave të organeve të përfshira. Gjithsesi, KPT-ja nxit fort krijimin e një organi të pavarur hetimor të specializuar. Një organ i tillë duhet të ketë kompetencën që të drejtojë fillimin e procedimeve disiplinore.

Panvarësisht nga struktura formale e organit hetimor, KPT-ja konsideron se funksionet e saj duhet të propogandohen në mënyrën e duhur. Përveç mundësisë që personat të paraqesin ankesa të drejtpërdrejta në këtë strukturë, duhet të jetë e detyrueshme që autoritetet publike si policia të regjistrojnë gjitha përfaqësimet që mund të përbëjnë një ankesë; në këtë pikë, format e duhura duhet të paraqiten për të vënë në dijeni marrjen e një ankese dhe për të konfirmuar faktin që çështja do të hapet.

Nëse në një çështje të caktuar konstatohet se sjellja e nëpunësve në fjalë mund të konsiderohet si penale, organi hetimor gjithmonë duhet të verifikojë drejtpërdrejtë – pa vonesë – autoritetet kompetente të akuzës.

39. I duhet kushtuar një kujdes i veçantë sigurimit të faktit që personat që mund të kenë qenë viktimë e një keqtrajtimi nga nëpunësit publikë të mos dekurajohen për të paraqitur një ankesë për keqtrajtimin në fjalë. Për shembull, efektet negative të mundshme të një mundësie që nëpunës të tillë të nisin procedime për shpifje kundër një personi që i akuzon ata padrejtësisht për keqtrajtim duhet të mbahet gjithmonë nën shqyrtim. Ekuilibri midis krahasimit të interesave legjitimë duhet të vendoset në mënyrë të barabartë. Gjithashtu duhet t'u referohemi në këtë kuadër disa çështjeve të përmendura në paragrafin 28.

40. Çdo prove keqtrajtimi e kryer nga nëpunësit publik që del gjatë **proceseve civile** gjithashtu duhet t'i nënshtrohet analizës të detajuar. Për shembull, në çështjet në të cilat ka pasur pretendime të suksesshme për dëme të shkaktuara në vendbanimet jashtë ambienteve të gjykatës me motive ku përfshihen edhe dhuna e shkaktuar nga policët, KPT-ja ka rekomanduar që të bëhet një analizë e pavarur. Një analizë e tillë duhet bërë me qëllim për të identifikuar nëse, duke pasur parasysh natyrën dhe shkallën e ashpërsisë së akuzave kundër policëve në fjalë, duhet konsideruar (rikonsideruar) çështja e hapjes së procedimeve penale dhe/ose disiplinore.

41. Është e qartë që panvarësisht sesa efektiv mund të jetë hetimi, do të ketë pak vlera nëse **sanksionet e imponuara për keqtrajtimin e ushtruar** do të jenë të pamjaftueshme. Në rastet kur është vërtetuar keqtrajtimi, imponimi i një dënimi të duhur duhet të vijojë pas kësaj. Kjo do të ketë një efekt mjaft të fortë bindës. Në të kundërt, imponimi i dënimeve të lehta vetëm mund të vënë në rrezik klimën e mosndëshkimit.

Sigurisht që autoritetet gjyqësore janë të pavarura e si rrjedhojë të lira për të vendosur, brenda parametrave të përcaktuara me ligj, dënimin në çdo çështje të dhënë. Gjithsesi nëpërmjet këtyre parametrave qëllimi i legjislatorit duhet të jetë i qartë: sistemi i drejtësisë penale duhet të përcaktojë një qëndrim të vendosur në lidhje me torturën dhe format e tjera të keqtrajtimit. Po kështu, sanksionet e imponuara në vijim të përcaktimit të fajësisë disiplinore duhet të shqyrtohen në bazë të shkallës së ashpërsisë së çështjes.

42. Së fundi, askush nuk duhet të mbetet me ndonjë dyshim në lidhje me **angazhimin e autoriteteve Shtetërore** për të luftuar mosndëshkimin. Kjo do të forcojë hapat që ndërmerren në këtë kuadër në të gjitha nivelet e tjera. Kur është e nevojshme këto autoritete nuk duhet të ngurrojnë që të dërgojnë nëpërmjet një deklaratë formale në nivelet më të larta politike mesazhin e qartë që nuk duhet të ekzistojë “tolerancë zero” në lidhje me torturën dhe format e tjera të keqtrajtimit.